



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 246 Akti

Nr. 269 Vendimi
Tiranë, më 1.7.2020

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Lulzim Hamitaj	Kryesues
Valbona Sanxhaktari	Anëtare
Genta Tafa (Bungo)	Relatore

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Fiorela Mandro, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Tonci Petrovic, më 29.6.2020, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (Ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (underground), Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Valdete Hoxha**, gjyqtare në Gjykatën e Apelit Tiranë.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Genta Tafa (Bungo), vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5 të nenit 179/b të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në pikën 5, të nenit 3, dhe në pikën 1, të nenit 5, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Subjekti i rivlerësimit, znj. Valdete Hoxha, aktualisht me funksionin gjyqtare në Gjykatën e Apelit Tiranë, është subjekt i rivlerësimit, që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni), ka hedhur shortin në datën 15.1.2019, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Valdete Hoxha, do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 4, i përbërë nga komisionerët znj. Genta Tafa (Bungo), znj. Valbona Sanxhaktari dhe z. Roland Ilia. Relator i çështjes, u zgjodh me short, komisionerja znj. Genta Tafa (Bungo).

4. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 18.1.2019, u caktua me mirëkuptim kryesues z. Roland Ilia, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Valdete Hoxha.

5. Më 28.10.2019, z. Roland Ilia ka deklaruar se sapa ishte vënë në dijeni të ekzistencës së kushteve të konfliktit të interesit me këtë subjekt dhe ka kërkuar përjashtimin e tij nga përbërja e trupit gjykues. Me vendimin e datës 29.10.2019, trupi gjykues, i ngritur për shqyrtimin e kësaj kërkesë me shortin e hedhur në datën 28.10.2019, vendosi pranimin e dorëheqjes së komisionerit Roland Ilia.

6. Komisioneri zëvendësues i zgjedhur me shortin e datës 15.1.2019 është z. Lulzim Hamitaj, i cili deklaroi mospasjen e konfliktit të interesit me këtë subjekt.

7. Referuar pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit, Valdete Hoxha, nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.

8. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij.

9. Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun V, “Kontrolli i figurës”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e

organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

10. Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun VI, “Vlerësimi i aftësive profesionale”, të ligjit nr. 84/2016, ka për objekt vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

11. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK); dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor. Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.

12. Në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, dërgoi raportin¹ e hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Valdete Hoxha. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, është konstatuar se:

- (i) *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- (ii) *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- (iii) *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- (iv) *nuk ka kryer deklarim të rremë dhe;*
- (v) *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

13. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka dërguar raportin² për subjektin e rivlerësimit, në përfundim të të cilit ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Valdete Hoxha.

14. Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar në zbatim të nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, një raport³ të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

15. Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi të tria kriteret: atë të vlerësimit të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale.

16. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, të kontrollit të figurës

¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 3.5.2018

² Raporti me nr. *** prot., datë 2.11.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin e KDZH-së nr. *** , datë 11. 9.2019

³ Me shkresën nr. *** prot., datë 5.6.2019

dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, në datën 19.6.2020, vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për tri kritere për subjektin e rivlerësimit (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t'u njohur me materialet e dosjes.

17. Subjekti i rivlerësimit, në të njëjtën datë, u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja ose thirrjen e dëshmitarëve, lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes në datën 22.6.2020 dhe ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja në datën 24.6.2020.

18. Pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjyqës, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore⁴.

II. SEANCA DËGJIMORE

19. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore publike me njoftimin e bërë elektronikisht me *e-mail*, në datën 25.6.2020.

20. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, më 29.6.2020, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (underground), Tiranë, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Tonci Petrovic.

21. Subjekti i rivlerësimit, znj. Valdete Hoxha, mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit, znj. Valdete Hoxha, kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

22. Znj. Valdete Hoxha ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj, duke u përgjigjur në kohë, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ.

22.1. Subjekti i rivlerësimit ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur, ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancave dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

23. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë". Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

23.1 Referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese, nr. 2/2017⁵ dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces

⁴ Vendimi i ndërmjetëm nr. 3, datë 25.6.2020

⁵ "41. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas

të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

23.2. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, “Vetting”; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar, “Vetting” të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e këtij subjekti, dërguar në Komision; (d) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportet e kontrollit të figurës të dorëzuar pranë këtij Komisioni nga DSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale, të dorëzuar pranë këtij Komisioni nga KLGJ-ja; (ë) denoncimet e publikut; dhe (f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit apo nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

24. Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së këtij subjekti. Hetimi i kryer nga Komisioni është përqëndruar në vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, si edhe burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre pasurive.

Në deklaratën “Vetting” (shtojca 2), të dorëzuar në ILDKPKI në datën 26.1.2017, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, kanë deklaruar se zotërojnë këto pasuri:

24.1 Apartament⁶ banimi 1+1 (parafabrikat), sipërfaqe 63 m², rruga “****”, pallati ***, shkalla ***, apartamenti nr. ***, Tiranë, si dhe shtesë me sipërfaqe 62 m², blerë mbi bazë kontrate shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.5.2007. Shtesa është në proces legalizimi. Vlera 2.000.000 lekë; pjesa takuese 50%.

Burimi sipas deklaratës “Vetting”: të ardhurat e akumuluar deri në vitin 2007, të tërhequra nga “Banka Amerikane”.

Hetimi⁷ i kryer nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

24.2 Në datën 16.5.2007, me kontratë shitblerjeje nr. ***, subjekti me bashkëshortin kanë blerë nga motra e z. A.H., (bashkëshorti i subjektit) dhe bashkëshorti i saj apartament me

nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelimit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelimit, Komisionerët Publik, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtar”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezultoi se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues, organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

⁶ **Subjekti ka dorëzuar këto dokumente:** (i) Certifikatë për vërtetim pronësie dt. 21.5.2007 për apartament me sipërfaqe 63 m², rruga “****”, në emër të A., dhe Valdete Hoxha; (ii) Kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.5.2007; (iii) Kontratë e kalimit të pronësisë së parcelës ndërtimore nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.10.2011

⁷ Shkresë nr.*** prot., datë 22.2.2019 drejtuar ALUIZNI-t; Kthim përgjigjeje ALUIZNI nr.*** prot., datë 13.3.2019; Kthim përgjigjeje Drejtoria e ALUIZNI Tiranë 2; Shkresë nr. *** prot., datë 22.2.2019 drejtuar Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme; Kthim përgjigjeje ZVRPP-ja Tiranë nr.*** prot., datë 25.3.2019; Shkresë nr.*** prot., datë 22.2.2019 drejtuar UKT-së; Kthim përgjigjeje UKT-ja nr. *** prot., datë 8.3.2019; Shkresë nr.*** prot., datë 22.2.2019 drejtuar OSHEE-së; Kthim përgjigjeje OSHEE-ja nr. *** prot., datë 4.3.2019

sipërfaqe 63.2 m² në rrugën “***”, së bashku me një shtesë me sipërfaqe 62 m² në proces legalizimi. Vlera e paguar në total 2.000.000 lekë, e cila është likuiduar tërësisht. Apartamenti ka numër pasurie ***, zona kadastrale ***.

24.3 Origjina e këtij apartamenti është kontrata e shitblerjes datë 11.4.1994, lidhur midis znj. S. J., dhe bashkëshortit të saj si palë blerëse dhe Ndërmarrjes Komunale - Banesa nr. ***, si palë shitëse.

📌 Hetimi/Analiza ligjore-financiare për burimin e krijimit të pasurisë së llojit “apartament”

24.4. Referuar deklaratës së rivlerësimit kalimtar “Vetting”, **subjekti ka deklaruar si burim të krijimit të pasurisë apartament**, pakësimin e depozitës në “Intesa San Paolo Bank” në shumën 2,000,000 lekë. I njëjti deklaram është bërë edhe në DVP-në e vitit 2007.

Analiza e kryer nga Komisioni në lidhje me burimin

24.4.1. Bazuar në shkresën e Intesa San Paolo Bank⁸ rezulton se:

- bashkëshorti i subjektit ka hapur një depozitë në shumën 1,000,000 lekë në datën 30.4.2002⁹, e cila është investuar në vijimësi në depozita me afat;
- Në vitin 2006 kjo depozitë është shtuar me shumën¹⁰ 989,913 lekë;
- Në datën 20.11.2007 shuma 2,010,044 lekë është transferuar në llogarinë e shitësve të apartamentit z. Z. J., dhe znj. S.J.

24.4.2. **Analizë financiare** (në lekë) mbi mundësinë e depozitimit të shumës 1,000,000 lekë në 30.4.2002

	<i>1992 deri 2001</i>	<i>2002</i>
PASURI	0	1,000,000
<i>Shtesa/pakësime likuiditete</i>		<i>1,000,000</i>
Likuiditete gjendje		1,000,000
TË ARDHURA dokumentuar	3,683,057	842,677
Të ardhura nga paga e subjektit	3,007,569	633,634
Të ardhura nga paga e Bashkëshortit	675,488	209,043
SHPENZIME	2,217,280	575,576
Shpenzime jetese	2,217,280	375,576
Qira Banese		200,000
Mundësia për kursime kumulative	1,465,778	732,879

Për analizën e mësipërme është përdorur metodologjia kumulative, sepse likuiditetet janë krijuar para deklaramit të parë.

Bazuar në analizën e mësipërme rezulton se subjekti ka patur të ardhura të mjaftueshme për krijimin e kësaj depozite.

24.4.3. Analiza (në lekë) mbi mundësinë e shtimit të depozitave gjatë vitit 2006

⁸ nr.*** prot., datë 5.3.2019

⁹ Deklaruar në DVP-në/2003

¹⁰ Bashkëshorti i subjektit në DVP-në/2006 deklaroi se ka shtuar shumën 850,000 lekë me burim gjendjen *cash* të akumuluar ndër vite, dhe 150,000 lekë me të ardhurat e vitit dhe kursime nga interesat bankare.

	6.2.2006	6/2 deri 13.11.2006
PASURI	-28,308	143,098
<i>Shtesa/pakësime likuiditete</i>	-28,308	143,098
Likuiditete gjendje	1,850,597	1,993,695
TË ARDHURA dokumentuar	180,488	1,179,264
Të ardhura nga paga e subjektit	131,615	948,202
Të ardhura nga paga e bashkëshortit	42,943	193,245
Interesa nga bankat	5,929	37,817
SHPENZIME	43,222	386,175
Shpenzime jetese	43,222	336,175
Shpenzime shkollimi për të birin		50,000
Mundësia për kursime	165,573	649,991

24.4.4. Nga verifikimi i deklarimeve periodike të bashkëshortit të subjektit rezulton se deri në fund të vitit 2005 ka patur gjendje *cash* shumë 850,000 lekë, shumë e cila është përfshirë në analizë financiare në datën 6.2.2006. Ndërkohë, në datën 13.11.2006 ai ka patur mundësi për të krijuar kursime në shumë 150,000 lekë, të cilat kanë shërbyer për të shtuar depozitën në “Bankën Amerikane” (sot “Intesa San Paolo Bank”).

24.4.5. Në përfundim të analizës, rezulton se subjekti ka patur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e likuiditeteve, të cilat kanë shërbyer si burim për blerjen e apartamentit në shumë 2,000,000 lekë.

24.5. Nga ana e ALUIZNI-t jemi informuar se A.H., është përfshirë në procedurën e legalizimit¹¹ në dosjen fizike në emër të Z.J., me nr. *** prot., datë 9.11.2006. Z. J., ka deklaruar në aplikim se sipërfaqja e ndërtimit është 58 m² dhe subjekti ndërtues ka qenë “***”.

24.5.1. Në datën 28.10.2011 me kontratën e kalimit të pronësisë së parcelës ndërtimore nr. ***, bashkëshorti i subjektit, së bashku me ndërtuesit e shtesave të kateve të tjera të objektit ku ndodhet apartamenti, kanë blerë nga ALUIZNI parcelë ndërtimore me sipërfaqe 69.1 m², me numër pasurie ***, zona kadastrale ***.

24.5.2. Vlera e paguar për parcelën është 141 120¹² lekë dhe vlera e paguar për taksën e ndikimit në infrastrukturë është 190, 604¹³ lekë. Në analizë financiare është përfshirë 1/5 pjesë takuese e këtyre shpenzimeve.

24.5.3. Për këtë ndërtim është lëshuar leja e legalizimit nr. *** në datën 15.11.2018. Në këtë leje, sipërfaqja e ndërtimit për banim është përcaktuar 69.1 m².

24.4.4 Komisioni i ka kërkuar informacion të detajuar subjektit të rivlerësimit në lidhje me shtesën e apartamentit si dhe me çmimin e ulët të blerjes së këtij apartamenti.

24.5.5. Në përgjigjen e saj, subjekti¹⁴ ka sqaruar se:

- i. Ndërtimi i shtesës në fazën e karabinasë ka përfunduar në vitin 1997. Punimet e brendshme të shtesës kanë filluar në vitin 1997 dhe kanë përfunduar brenda vitit 1998. Shtesa është ndërtuar nga z. Z.J., dhe bashkëshortja e tij S.J. Subjekti ka vendosur në dispozicion dokumentacion provues (tri urdhërzhirime të datës 31.8.1997) në lidhje me

¹¹ Urdhër ***, nr.*** prot., datë 29.9.2011

¹² Paguar në datën 19.3.2010 në “Credins Bank”

¹³ Paguar në datën 3.9.2009 në “Credins Bank”

¹⁴ Shih shpjegimet e subjektit në përgjigje të pyetësorit nr.1

disa pagesa të kryera në favor të shoqërisë “***” në shumën totale 450,000 lekë nga z. Z. J., (shuma 150,000 lekë) dhe banorët e tjerë të pallatit.

- ii. Burimi i të ardhurave për ndërtimin e kësaj shtese kanë qenë nga puna dhe kursimet e tyre ndër vite. Subjekti ka vënë në dispozicion të Komisionit dokumentacion provues në lidhje me të ardhurat e familjes J., nga ku rezulton se ato kanë patur të ardhura të mjaftueshme për ndërtimin e kësaj shtese.
- iii. Subjekti ka depozituar ortofoto të vitit 2007 dhe 1994, nga ku rezulton se shtesa ka qenë e përfunduar në vitin 2007.
- iv. Në lidhje me mospërputhjet e sipërfaqeve të shtesës, subjekti sqaron se deklarimi prej 62 m² në kontratën e shitjes përbën vetëm sipërfaqjen e ndërtimit, duke mos përfshirë sipërfaqen e ballkonit, i cili është konsull, sikurse rezulton dhe nga planimetria e objektit (shtesë anësore). Në lejen e legalizimit është përfshirë dhe sipërfaqja e ballkonit. Në lidhje me sipërfaqen në vetëdeklarim: ajo është bërë me përafërsi referuar sipërfaqes së përafërt të shfrytëzueshme.
- v. Në lidhje me çmimin e apartamentit krahasuar me vlerën e tregut, subjekti sqaron se:
 - Në çmimin e referuar nuk është marrë parasysh pozicioni dhe zona ku ndodhet pasuria, viti i ndërtimit para vitit 90, fakti që pallati ekzistues është me strukturë “parafabrikat”.
 - Shitja e apartamentit nga ana e bashkëshortëve J., është kryer në rrethana të posaçme, të lidhjes së ngushtë mes bashkëshortit të saj dhe motrës së tij, si dhe nga fakti se ata duke qenë prej disa vitesh në Kanada, tashmë ishin stabilizuar mjaft mirë, çfarë ka bërë që çmimi i shitjes të caktohej në një vlerë që do të ishte i përbalueshëm prej subjektit. Ata jo vetëm që nuk kanë dashur të përfitojnë, por përkundrazi kanë synuar t'i ndihmojnë.Subjekti për të vërtetuar deklarinin e saj në lidhje me çmimin ka depozituar kontrata të ngjashme të shitjes së apartamenteve në të njëjtën kohë dhe në të njëjtën zonë.

24.5.6. Nga përgjigjet e subjektit si dhe dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se apartamenti është pallat ekzistues “parafabrikat” i ndërtuar para vitit 1990, nga kontratat e ngjashme rezulton se çmimi i blerjes së këtij apartamentit përafrohet me çmimin e blerjes së apartamenteve të ngjashme. Duke marrë në konsideratë dhe faktin e marrëdhënieve të posaçme dhe të emigrimit në Kanada të shitësit justifikohet vlera e blerjes së këtij apartamenti në shumën 2,000,000 lekë.

24.6. Nga verifikimi i DVP-ve rezulton se subjekti ka jetuar në këtë apartament që në vitin 2002 me qira deri në 2005 dhe më pas me kontratë huapërdorjeje. Ky fakt është konfirmuar dhe nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr.1, e cila ka depozituar dokumentacion provues si më poshtë:

- i. Kontratë qiraje, nr. ***, datë 5.11.2002;
- ii. Kontratë huapërdorjeje, nr. ***, datë 9.8.2006.

24.7. OSHEE-ja dhe UKT-ja konfirmojnë kontratat e furnizimit në emër të z. A.H., pas vitit 2007.

24.8. Në përfundim të hetimit, Komisioni konstaton se subjekti ka deklaruar saktë dhe qartë pasurinë e tij. Ai ka provuar me dokumentacion aftësitë paguese për blerjen e apartamentit. Duke qenë se përputhet deklarimi i subjektit me të dhënat e administruara, nuk kanë lindur dyshime apo paqartësi për këtë pasuri.

25. Autoveturë¹⁵ tip “Ford Fokus”, me kontratë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.7.2015, autovetura ka kaluar në bashkëpronësi me bashkëshortin. Vlera 14.000 euro, pjesa takuese 50%.

Burimi sipas deklaratës “Vetting”¹⁶: Kontratë qiraje financiare nr. ***, datë 25.7.2011, nga shoqëria “Tirana Leasing”, me vlerë 14.000 euro, nga të cilat 7.000 euro paguar nga kursimet e të ardhurave dhe 7.000 euro me qira, me interes 8% dhe afat shlyerjeje katër vite.

Hetimi¹⁷ i kryer nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

25.1. Në datën 25.7.2011 subjekti dhe bashkëshorti i saj kanë lidhur kontratë themelore të qirasë financiare (leasing) nr. *** me shoqërinë “Tirana Leasing” sh.a., nëpërmjet së cilës marrin me qira financiare, automjetin tip “Ford”, në vlerën 14.000 euro. Afati i qirasë fillon pas nënshkrimit të shtojcës së kontratës themelore dhe përfundon më 14.7.2015. Shuma e qirasë 7.000 euro. Diferenca 7.000 euro është paguar nga subjekti në formë paradhënie.

25.2. Me kontratë shitje nr. “****”, datë 15.7.2011, subjekti dhe bashkëshorti i saj kanë blerë nga shoqëria “****” sh.p.k., automjetin tip “Ford”, në vlerën 14.000 euro. Në kontratë përcaktohet se parapagimi në llogari të shitësit për *leasing* -7.000 euro - do të paguhet menjëherë, ndërsa pjesa e mbetur 7.000 euro do të paguhet para marrjes së automjetit në dorëzim.

25.3. Subjekti, për të provuar shlyerjen e shumës 14.000 euro, ka vënë në dispozicion depozitë në arkë në “Tirana Bank”, për pagesa kështu *leasing* si më poshtë:

- datë 19.7.2011 shuma 7.000 – 50% e vlerës së makinës, parapaguar nga subjekti
- datë 4.8.2011 shuma 300 euro
- datë 15.8.2011 shuma 300 euro
- datë 11.11.2011 shuma 500 euro
- datë 16.1.2012 shuma 800 euro
- datë 23.5.2012 shuma 1.000 euro
- datë 1.11.2012 shuma 1.000 euro
- datë 12.11.2013 shuma 1.000 euro
- datë 10.5.2013 shuma 1.500 euro
- datë 11.7.2014 shuma 1.000 euro
- datë 28.1.2015 shuma 1.000 euro

Në total 15.400 euro, nga të cilat 7.000 euro janë parapaguar nga subjekti dhe 8,400 euro të depozituara për shlyerjen e kësteve.

25.4. Në datën 6.7.2015, me kontratë shitblerjeje nr. ***, automjeti ka kaluar në bashkëpronësi të subjektit dhe bashkëshortit të saj.

25.5. Analizë financiare (në lekë)

¹⁵ Subjekti ka dorëzuar këto dokumente: (i) Kontratë shitblerjeje automjeti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.7.2015; (ii) Kontratë themelore e qirasë financiare (leasing) nr.***, datë 25.7.2011 dhe nr. *** rep., nr.*** kol; (iii) Kontratë shitjeje nr. “****”, datë 15.7.2011, ndërmjet A., e Valdete Hoxha dhe firmës “****” sh.p.k., për blerjen e automjetit tip “Ford”, viti prodhimit 2011, targa ***, në vlerën 14.000 euro; (iv) Konfirmë bankare nga “Tirana Bank” datë 19.7.2011; (v) Konferma bankare të depozitimeve pranë “Tirana Bank”, për pagesa “kështu leasing” datë 17.8.2011, shuma 300 euro; datë 18.4.2011 shuma 300 euro; datë 16.1.2012 shuma 800 euro; datë 11.11.2011 shuma 500 euro; datë 11.11.2011 shuma 1.000 euro; datë 23.5.2012 shuma 1.000 euro; datë 11.12.2013 shuma 1.000 euro; datë 5.10.2013 shuma 1.500 euro; datë 7.11.2014 shuma 1.000 euro; datë 28.1.2015 shuma 1.000 euro.

¹⁶ I njëjti burim si në deklaratën “Vetting” është deklaruar dhe në DVP-në/2011

¹⁷ Shkresë nr.*** prot., datë 22.2.2019 drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të transportit Rrugor; Kthim përgjigjeje DPSHTRR-ja nr.*** prot., datë 27.12.2019; Shkresë nr. *** prot., datë 22.2.2019 drejtuar bankave; Kthim përgjigjeje “Tirana Bank” nr. *** prot., datë 8.3.2019

	2011	2012	2013	2014	2015
PASURI	2 209 297	810 457	731 479	283 916	386 497
Makinë "Ford Focus" ***	1 936 200				
<i>Shtesa/pakësime likuiditete</i>	<i>273 097</i>	<i>810 457</i>	<i>731 479</i>	<i>283 916</i>	<i>386 497</i>
Likuiditete gjendje	3 273 498	4 083 956	4 815 435	5 099 351	5 485 848
TË ARDHURA dokumentuar	3 186 127	2 322 250	1 989 149	2 108 783	2 186 478
Të ardhura nga paga e subjektit	1 223 437	1 254 825	1 282 997	1 366 577	1 378 464
Të ardhura nga paga e bashkëshortit	590 470	613 071	635 716	718 965	773 638
Kredi "Tirana Leasing"	968 100				
Dhuratë nga motra e bashkëshortit	312 919	308 473			
Interesa nga Bankat	66 200	80 881	70 436	23 241	34 376
S. H., (e bija) për rezultate në shkollë	25 000	65 000			
SHPENZIME	872 296	962 795	818 717	1 113 373	915 954
Shpenzime jetese	546 480	511 676	423 072	659 994	672 828
Shpenzime udhëtimi TIMS	47 714	87 325	30 846	89 472	0
Paguar këste kredie <i>leasing</i>	121 308	286 521	287 526	286 634	156 453
Shpenzime kredie	14 522				
Shpenzime riparimi/arredimi (P. Standard)	77 273	77 273	77 273	77 273	77 273
Shpenzime të ndryshme të evidentuara					9 400
Shpenzime shkollimi (i biri)	65 000				
Mundësia për kursime	104 534	548 998	438 953	711 494	884 027

25.6. Nga analiza financiare konstatohet se subjekti ka patur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e kësaj pasurie. Përputhet deklarimi i subjektit me të dhënat e administruara.

26. Depozitë¹⁸ bankare pranë "Intesa SanPaolo Bank", në bashkëpronësi me bashkëshortin. Vlera 2.343.023 lekë, pjesa takuese 50%.

Burimi sipas deklaratës "Vetting": Krijuar nga kursimet ndër vite nga pagat dhe interesat.

Hetimi¹⁹ i kryer nga Komisioni lidhur me këtë depozitë

26.1. Nga nxjerrja e llogarisë së subjekti në "Intesa San Paolo Bank" rezulton se:

26.1.1. Në datën.5.12.2007, subjekti ka depozituar shumën 1,000,000 lekë²⁰.

Subjekti ka patur të ardhura të mjaftueshme për krijimin e kësaj depozite, pasi si burim ka shërbyer gjendja *cash* në shumën 600,000 lekë deklaruar në DVP-në/2006, ndërsa diferenca prej 400,000 lekë është krijuar nga kursimet e vitit 2007. Nga analiza financiare e vitit 2007 rezulton se subjekti ka patur të ardhura të mjaftueshme për të krijuar kursime në shumën 400,000 lekë.

26.1.2. Në datën 12.1.2011 ka depozituar shumën 1,000,000 lekë²¹.

Subjekti ka patur të ardhura të mjaftueshme për krijimin e kësaj depozite, pasi ajo ka patur gjendje të akumuluar *cash*, të deklaruar ndër vite, e cila arrin në shumën 1, 486,000 lekë²² në fund të vitit 2010.

¹⁸ Subjekti ka dorëzuar këto dokumente: (i) Konfirmim nga ISPB-ja, datë 24.10.2016, për gjendjen e llogarisë datë 24.10.2016, në shumën 2.343.024 lekë; (ii) Tabela e interesave nga data 5.10.2007; (iii) Statement e gjendjes së klientit dhe nxjerrje llogarie datë 24.10.2016

¹⁹ Shkresë nr.*** prot., datë 22.2.2019 drejtuar Bankave; Kthim përgjigjeje nr.*** prot., datë 5.3.2019 "Intesa San Paolo Bank";

²⁰ Si burim për këtë shumë në DVP-në/2007 është deklaruar gjendje *cash* 600,000 lekë e vitit 2006 dhe kursimet e vitit 2007

²¹ Si burim për këtë shumë në DVP-në/2010 është deklaruar gjendje *cash* ndër vite

²² Shih DVP-në 2006 deri DVP-në 2010

26.2. Në datën 26.1.2017, subjekti i rivlerësimit ka në “Intesa San paolo Bank” dy depozita: 1, 000, 000 lekë dhe 1,178,568.50 lekë si dhe gjendje në llogari rrjedhëse 168,553.46 lekë. Në total, shumën 2,347,122.

26.3. Komisioni konstaton se përputhet deklarimi i subjektit me të dhënat e administruara.

27. Depozitë²³ bankare pranë “Raiffeisen Bank”. Vlera 2.075.698 lekë; pjesa takuese 100%. **Burimi sipas deklaratës “Vetting”:** Nga kursimet e pagës sime, bashkëshortit dhe interesat, ndër vite. (Depozituar në vite kursime *cash* dhe teprica nga llogaria rrjedhëse)

28. Llogari rrjedhëse pranë “Raiffeisen Bank”, krijuar nga paga si gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Tiranë. Gjendja në datën 24.1.2017; vlera 196.907 lekë; pjesa takuese 100%.

Rezultati i hetimit²⁴

28.1. Nga nxjerrja e llogarisë së subjektit në “Raiffeisen Bank” rezulton se gjendja në datë 23.1.2017 është 196,907 lekë. Nga kjo llogari janë krijuar dy depozita²⁵, secila në shumën 1,000,000 lekë.

28.2. Depozita e parë është krijuar në datën 13.4.2011. Nga analiza financiare (në lekë) më poshtë, rezulton se subjekti ka patur të ardhura të mjaftueshme për krijimin e kësaj depozite.

	13.4.2011
PASURI	358,314
<i>Shtesa/pakësime likuiditete</i>	358,314
Likuiditete gjendje	3,358,652
TË ARDHURA dokumentuar	639,741
Të ardhura nga paga e subjektit	401,292
Të ardhura nga paga e bashkëshortit	238,449
SHPENZIME	174,309
Shpenzime jetese	152,715
Shpenzime riparimi/arredimi (Pyetëtori standard)	21,594
Mundësia për kursime	107,118

28.3. Në DVP-në/2010 subjekti ka deklaruar kursime nga të ardhurat vjetore në shumën 700,000 lekë, por pa specifikuar nëse janë *cash* apo në bankë. Në lidhje me këtë konstatim, në përgjigje të pyetësit të parë, ajo ka sqaruar se këto kursime në fund të vitit të deklarimit 31.12.2010 ndodhen në llogari rrjedhëse 514.000 lekë, pjesa tjetër *cash* në banesë. Nga ana e Komisionit është verifikuar ky deklarim i subjektit nga ku rezulton se ajo në fund të vitit 2010 ka patur në llogarinë rrjedhëse në “Raiffeisen Bank” shumën 513,686 lekë. Kjo shumë së bashku me gjendjen *cash* të akumuluar ndër vite në shumën totale 1, 486,000 lekë ka shërbyer për krijimin e depozitës së mësipërme.

28.4. Depozita e dytë është krijuar në datën 24.4.2015 si rrjedhojë e akumulimeve nga paga e subjektit, të patërhequra nga banka si dhe gjendja *cash* ndër vite. Nga analiza financiare (në lekë) më poshtë rezulton se subjekti ka patur të ardhura të mjaftueshme për krijimin e kësaj depozite.

²³ Subjekti ka dorëzuar: Statement bankar nga “RFB”, datë 24.10.2016, për periudhën 18.3.2005-24.10.2016.

²⁴ Shkresë nr.*** prot., datë 22.02.2019 drejtuar bankave; Kthim përgjigjeje “Raiffeisen Bank” nr.*** prot., datë 27.2.2019.

²⁵ Depozita e parë në datën 13.4.2011 deklaruar në DVP-në/2011 dhe depozita e dytë në datë 24.4.2015 deklaruar në DVP-në/2015.

	24.4.2015
Pasuri	361,314
<i>Shtesa/pakësime likuiditete</i>	<i>361 314</i>
Likuiditete gjendje	5 460 665
Të Ardhura dokumentuar	666,904
Të ardhura nga paga e subjektit	462,850
Të ardhura nga paga e bashkëshortit	192,265
Interesa nga Bankat	11,789
Shpenzime	304,289
Shpenzime jetese	210,144
Paguar këste tek “Tirana Leasing”	94,146
Mundësia për kursime	1,301

28.5. Nga hetimi administrativ i kryer rezulton se përputhet deklarimi i subjektit me të dhënat e administruara. Subjekti ka mjete monetare të mjaftueshme.

DEKLARIMI I BASHKËSHORTIT TË SUBJEKTIT

29. Bashkëpronar²⁶ në banesën²⁷ 1 kat, e ndodhur në ***, Malësi e Madhe, me sipërfaqe 110 m² dhe truall përkatës me sipërfaqe 420 m², regjistruar në regjistrin hipotekor nr. ***, datë 29.10.2015, numri i pasurisë ***, zona kadastrale ***. Pjesa takuese 1/8 pjesë.

Burimi sipas deklaratës “Vetting”: Trashëguar pas vdekjes së babait, I. H., sipas dëshmisë trashëgimisë ligjore me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.10.2015, të noterit S.K.

Rezultati i hetimit²⁸

29.1. Në datën 29.10.2015, është lëshuar dëshmia e trashëgimisë ligjore nr. *** për babain e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit. Bazuar në këtë dëshmi, bashkëshorti i subjektit ka trashëguar ¼ pjesë të pasurisë trashëgimore të babait të tij.

29.2. ASHK-ja Malësi e Madhe na informon se në emër të A.H., figuron e regjistruar në bashkëpronësi²⁹ pasuria nr. ***, zona kadastrale ***, lloji i pasurisë “truall” me sipërfaqe 420 m². Në kartelën e pasurisë tek seksioni “përshkrimi i veçantë” është shënimi: godinë banimi 1 kat, kati përdhe banim, sipërfaqja 94.7 m², sipërfaqe ndihmëse 15.3 m².

29.3. Origjina e kësaj pasurie është nga trashëgimia.

29.4. Nga hetimi ka rezultuar se babai i bashkëshortit të subjektit ka aplikuar për procedurë legalizimi për këtë banesë me kërkesën nr. *** prot., datë 1.9.2006. Leja e e legalizimit është lëshuar më 4.12.2012 me nr. *** për godinë banimi 1 kat, ***, Shkodër.

29.5. Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar. Nuk rezultojnë paqartësi në lidhje me këtë pasuri.

²⁶ Subjekti ka dorëzuar këto dokumente: (i) Vërtetim nga dokumenti hipotekor nr. ***, datë 29.10.2015 dhe nr. ***, dt. 9.4.2013, për pasurinë nr. ***, zona kadastrale ***, truall + ndërtesë me siërfaqe 420 m²; (ii) Dëshmi trashëgimie me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.10.2015.

²⁷ Kjo pasuri rezulton e deklaruar dhe në DVP-në 2015.

²⁸ Shkresë nr.*** prot., datë 22.2.2019 drejtuar ALUIZNI-t; Kthim përgjigjeje ALUIZNI nr.*** prot., datë 13.3.2019; Shkresë nr. *** prot., datë 22.2.2019 drejtuar Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme; Kthim përgjigjeje ZVRPP-ja Malësi e Madhe nr. *** prot., datë 7.3.2019.

²⁹ 1/8 pjesë takuese.

30. Llogari rrjedhëse³⁰ page pranë “Raiffeisen Bank”. Vlera 53.100 lekë; pjesa takuese 100%.

Burimi sipas deklaratës “Vetting”: Krijuar nga paga si specialist pranë ZQRPP-së Tiranë.

Rezultati i hetimit³¹

30.1. Bazuar në nxjerrjen e llogarisë së bashkëshortit të subjektit në “Raiffeisen Bank” rezulton se në datën 16.1.2017 gjendja e llogarisë është në shumën 53.131 lekë.

30.2. Nga nxjerrja e llogarisë së bashkëshortit të subjekti në monedhën dollar kanadez (CAD) rezulton se znj. S.J., ka depozituar shumat e mëposhtme:

- 24.12.2010 1,970 CAD ose 205 451 lekë;
- 06.06.2011 2,969 CAD ose 312 919 lekë;
- 04.07.2012 2,970 CAD ose 315 919 lekë.

Të tria këto depozitime janë deklaruar në deklaratat periodike në vitet përkatëse, ndërkohë në deklaratën “Vetting” janë deklaruar vetëm dy shumat e para.

30.3. Subjekti së bashku me deklaratën “Vetting” ka vënë në dispozicion dokumentin veprim arke nga “Raiffeisen Bank”, për tërheqje në datë 29.12.2010 të shumës 1.970 CAD ose 205 451 lekë dhe dokumentin tërheqje nga llogaria për tërheqje në datën 19.7.2011 të shumës 2.970 CAD ose 315 919 lekë; të dyja tërheqjet janë bërë nga bashkëshorti i subjektit.

Në pyetësin standard subjekti ka deklaruar se bashkëshorti i saj ka marrë dhuratë nga motra e tij shumën 2.970 CAD ose 315 919 lekë në vitin 2012.

30.4. Në përfundim të hetimit, pasi vlerësoi mundësitë financiare të motrës së bashkëshortit, deklarimin ndër vite të subjektit, deklarimin e saj në përgjigje të pyetësin standard, dokumentacionin bankar të administruar, vlerëson se motra e bashkëshortit i justifikon këto shuma të dhuruara vëllait të saj me mjete financiare me burim të ligjshëm. Ky fakt mbështetet në dokumentacionin e administruar nga Komisioni. Ndërkohë, konstatohet se subjekti i ka deklaruar ndër vite këto dhurime, por në deklaratën “Vetting” ka deklaruar vetëm dy prej tyre. Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka patur për qëllim fshehjen e faktit, përderisa ai e ka deklaruar atë në DPV-të përkatëse, në pyetësin standard të dërguar nga Komisioni, si dhe është një veprim i kryer nëpërmjet bankës. Komisioni e konsideron si pasaktësi, që nuk dëmton pozitën e subjektit, për aq sa vërtetohet me prova dokumentare.

31. Gjendje Cash deri më 26.1.2017 (Gjendja është akumuluar nga kursimet vit pas viti, deklaruar në deklaratat e interesave private). Vlera 350.000 lekë, pjesa takuese 100%.

31.1 Në fund të vitit 2016 gjendja e akumuluar e *cash*-it nga analiza financiare³² është 349,550 lekë³³, për rrjedhojë, subjekti ka patur të ardhura të mjaftueshme për të patur gjendje *cash* në shumën 350,000 lekë. Këto të ardhura janë akumulim i pagës së subjektit dhe bashkëshortit të saj.

DEKLARIMI I VAJZËS SË SUBJEKTIT – S. A. H.

32. Aksione³⁴ pranë “****.”; vlera 3.078,16 CAD; pjesa takuese 100%.

³⁰ Subjekti ka dorëzuar : Statement bankar datë 26.1.2017 dhe datë 25.10.2016, nga “RFB”.

³¹ Shkresë nr.*** prot., datë 22.2.2019 drejtuar Bankave; Kthim përgjigjeje “Raiffeisen Bank” nr.*** prot., datë 27.2.2019

³² Për burimin e ligjshëm të gjendjes *cash* akumuluar, shih analizën e viteve 2012-2016.

³³ Shih DVP-të 2012 – 2016.

³⁴ Subjekti ka dorëzuar këto dokumente: (i) *Statement i llogarisë në emër të S. H., për periudhën 20.12.2016-20.1.2017, në shumën 3.076 CAD, nga “****” për kompaninë “****”;* (ii) *Statement i llogarisë në emër të S. H., për periudhën 9.5.2016-15.10.2016, nga “****” për kompaninë “****”.*

Burimi sipas deklaratës “Vetting”: Fituar nga data 9 maj 2016 deri në datën 20 janar 2017, të mbajtura nga paga, vlera e aksioneve në CAD (dollar kanadez).

Rezultati i hetimit

32.1. Bazuar në dokumentin e shoqërisë “****” “nxjerrje llogarie” për periudhën 20.12.2016-20.1.2017 znj. S. H., ka patur në pronësi aksione në vlerën 3,078.16 CAD ose 292 702 lekë³⁵ në shoqërinë “****” në fillim të vitit 2017, në gjysmën e të cilave në vlerën 1,539.08 ose 146 351 lekë CAD si përfituese³⁶ rezulton znj. S.J.

32.2. Subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr.1, ka depozituar dokumentacion provues në lidhje me aksionet e znj. S.H., në shoqërinë “****”, nga ku rezulton se ajo aktualisht ka aksione me vlerë totale 19,399.98 CAD ose 1,597,976 lekë³⁷. Bazuar në kontratën e punës të vajzës së saj (subjekti ka vënë në dispozicion paragrafin ku parashikohet kontributi i punëdhënësit) punëdhënësi ka kontribuar në blerjen e 50% të shumës aksioneve.

32.3. Komisioni, pasi analizoi dokumentacionin e administruar, konstaton se vajza e subjektit ka një kontratë pune me shoqërinë kanadeze “****”. Këto aksione, të deklaruara në deklaratën “Vetting”, janë rrjedhojë e punës së saj në këtë shoqëri, si dhe detyrimeve të parashikuara në kontratën e punës. Komisioni e konsideron deklarinimin të saktë dhe të mbështetur në dokumentacion.

33. Llogari në bankën “TD”³⁸ - llogari rrjedhëse (llogari nga paga në CAD (dollar kanadez). Vlera 24.393,66 CAD, pjesa takuese 100%.

34. Llogari në bankën “TD” - llogari depozite (llogari nga paga në CAD (dollar kanadez). Vlera 6.175,54 CAD, pjesa takuese 100%.

Rezultati i hetimit

34.1. Bazuar në vërtetimin e Bankës “TD Canada Trust” të datës 21.1.2017 rezulton se vajza e subjekti ka:

- Llogari rrjedhëse me gjendje 24,393.66 CAD ose 2 319 593 lekë;
- Llogari Depozite me gjendje 6,175.54 CAD ose 587 232 lekë.

34.2. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit nr.1, ka vendosur dokumentacion provues në lidhje me këto llogari bankare. Konstatohet se këto llogari e kanë burimin nga të ardhurat nga paga e vajzës së subjektit. Në përfundim, konkludohet se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar.

35. Në lidhje me mundësinë financiare të vajzës dhe djalit të subjektit për të paguar shpenzimet e shkollimit

35.1 Në lidhje me shpenzimet e shkollimit të fëmijëve të subjektit të rivlerësimit.

Nga dokumentacioni i administruar gjatë hetimit administrativ rezulton se:

a. Shpenzimet e shkollimit të vajzës së subjektit janë si më poshtë:

³⁵ Kursi i këmbimit CAD:Lek 31.12.2016, Banka e Shqipërisë.

³⁶ Subjekti ka sqaruar se S. J., është “beneficiary” në rast se vajza e saj S.H., ndërrohet jetë.

³⁷ Kursi i këmbimit CAD: Lek data 5.8.2020, Banka e Shqipërisë.

³⁸ **Subjekti ka dorëzuar:** Vërtetim nga Banka “TD Canada Trust” i datës 21.01.2017

- Në datën 11.9.2012 është paguar shuma 11,488 CAD ose 1 221 970 lekë;

Viti 2012: total **11,488 CAD** ose 1 221 970 lekë.

- Në datën 3.1.2013 është paguar shuma 5,808 CAD ose 555 826 lekë;
- Në datën 3.1.2013 është paguar shuma 1,000 CAD ose 95 700 lekë;
- Në datën 21.9.2013 është paguar shuma 8,552 CAD ose 818 426 lekë;
- Në datën 21.9.2013 është paguar shuma 4,000 CAD ose 382 800 lekë.

Viti 2013: total **19,360 CAD** ose 1 852 752 lekë

- Në datën 25.1.2014, është paguar shuma 13,480 CAD ose 1 341 934 lekë;
- Në datën 20.9.2014 është paguar shuma 14,924 CAD ose 1 485 684 lekë.

Viti 2014: total **28,404 CAD** ose 2 827 618 lekë.

- Në datën 21.1.2015 është paguar shuma 14,841 CAD ose 1 343 556 lekë.
- Në datën 24.9.2015, është paguar shuma 12,736 CAD ose 1 152 990 lekë.

Viti 2015: total **27,577 CAD** ose 2 496 546 lekë.

- Në datën 16.1.2016 është paguar shuma 5,000 CAD ose 475 450 lekë.
- Në datën 16.1.2016 është paguar shuma 7,754 CAD ose 737 328 lekë.

Viti 2016 Total **12,754 CAD** ose 1 212 778 lekë.

b. Shpenzimet e shkollimit të djalit të subjektit janë si më poshtë:

Subjekti në deklaratën “Vetting” ka deklaruar se djali O. H., ka filluar vitin e parë të studimeve³⁹ në vitin 2016 pranë universitetit të A., në Kanada. Jeton me hallën e tij (dhe me të motrën). Për semestrin e parë janë paguar nga ana e saj 5.990 euro.

- Në datën 16.9.2016 është paguar shuma 5 990.31 euro ose 810 309 lekë.

Viti 2016: total **5 990.31 euro** ose **810 309 lekë**.

- Në datën 11.10.2017 është paguar shuma 15,132.23 CAD ose 1 341 321 lekë;
- Në datën 23.1.2017 është paguar shuma 12,619.64 CAD ose 1 118 605 lekë.

Viti 2017: total **27,751.87 CAD** ose **2 459 926 lekë**.

- Në datën 17.1.2018 është paguar shuma 15,468.19 CAD ose 1 225 390 lekë;
- Në datën 30.8.2018 është paguar shuma 16,595.32 CAD ose 1 314 681 lekë.

Viti 2018: total **32,063.15 CAD** ose **2 540 071 lekë**

- Në datën 15.1.2019 është paguar shuma 16,351.62 CAD ose 1 363 398 lekë;
- Në datën 13.9.2019 është paguar shuma 17,788.01 CAD ose 1 483 164 lekë.

Viti 2019: total **34,139.63 CAD** ose **2,846,562 lekë**.

35.2 Në lidhje me të ardhurat e fëmijëve të subjektit të rivlerësimit

35.2.1 Nga dokumentacioni i administruar gjatë hetimit administrativ rezulton vajza e subjektit të rivlerësimit ka patur **të ardhurat** e mëposhtme vjetore:

- Viti 2012 – 4.500 CAD ose 478 665 lekë;
- Viti 2013 – 3,428.92 CAD ose 328 148 lekë;
- Viti 2014 – 9,765.42 CAD ose 972 148 lekë;

³⁹ Subjekti ka dorëzuar këto dokumente: (i) Konfirmim pagese nga “Tirana Bank”, datë 20.9.2016, për kalimin e shumës 5.990 euro Universitetit të A.; (ii) Të dhëna për pagesën e Universitetit; (iii) Depozitë në arkën në “Tirana Bank” nga A. H., në shumën 5.500 euro, datë 15.9.2016 dhe në shumën 500 euro në datën 16.9.2016; (iv) Faturë *exchange* për konvertimin e shumës 5500 euro.

- Viti 2015 – 11,103 CAD ose 1 005 155 lekë;
- Viti 2016 – 53,208 CAD ose 5 059 549 lekë;
- Viti 2017 –72,214 CAD ose 6 401 049 lekë;
- Viti 2018 – 76,993 CAD ose 6 099 385 lekë.

35.2.1.1 Në DVP-në/2012 vajza e subjektit deklaron:

- Transfertë në bankën “TD Canada Trust” datë 7.9.2012, shuma 2,000 CAD ose 212 740 lekë; **dhuratë nga halla.**
- Transfertë në bankën “TD Canada Trust” datë 11.9.2012, shuma 1,500 CAD ose 159 555 lekë; **dhuratë nga halla.**

Në total shuma 372 295 lekë.

Të dyja këto shuma konfirmohen nga nxjerrja e llogarisë së vajzës së subjektit në bankën “TD Canada Trust”. Këto dy shuma nuk janë deklaruar në deklaratën “Vetting”. Ndërkohë subjekti i ka deklaruar në pyetësonin standard. Në përgjigje të pyetësonit nr.1, subjekti sqaron se ka konstatuar faktin e mospasqyrimin të kësaj shume, pasi është dorëzuar deklarata “Vetting” dhe ka reflektuar duke e pasqyruar këtë shumë në përgjigjet e pyetësonit standard. Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka patur për qëllim fshehjen e këtyre të ardhurave, përderisa ajo i ka shprehur në pyetësonin standard të dërguar nga Komisioni, si dhe është një veprim i kryer nëpërmjet bankës. Komisioni e konsideron si pasaktësi që nuk dëmton pozitën e subjektit, për aq sa vërtetohet me prova dokumentare (*shiko vlerësimin në pikën 30.4. të këtij vendimi*).

35.2.1.2. Në deklaratën “Vetting”⁴⁰ vajza e subjektit deklaron se ka marrë **hua** nga halla e saj S. J., për arsimim pranë Universitetit të A., gjatë periudhës shtator 2012 - prill 2016. Fillimi i shlyerjes së huas është me fillimin e punës (data e fillimit të punës është 9 maj 2016). Kësti mujor është jo më pak se 10% e të ardhurave mujore dhe me kohëzgjatje deri në shlyerjen e plotë. Detyrim i mbetur pa shlyer 81.600 CAD ose 7 759 344 lekë.

35.2.1.2.1. Për të provuar huan subjekti ka depozituar aktmarrëveshje ndërmjet huadhënëses S.J., (motra e bashkëshortit të saj) dhe huamarrëses S.H., (vajza e subjektit) për të paguar detyrimin financiar shkollor të saj pranë Universitetit të A., Kanada në datat e mëposhtme:

- datë 10.9.2012, shuma 11.487 CAD ose 1 221 970 lekë ;
- datë 2.1.2013, shuma 13.552 CAD ose 1 296 952 lekë;
- datë 5.1.2014, shuma 28.405 CAD ose 2 827 722 lekë;
- datë 2.1.2015, shuma 27.577 CAD ose 2 496 577 lekë;
- datë 5.1.2016, shuma 12.754 CAD ose 1 212 791 lekë.

Total 93,775 CAD ose 9 056 013 lekë.

Në të gjitha aktmarrëveshjet deklarohet se shumat do të kalojnë direkt nga llogaria bankare e S. J., në llogarinë bankare të Universitetit të A. Huaja do të kthehet pa interes dhe kthimi i saj do të nisë kur huamarrësja të fillojë punën. Mënyra e kthimit do të jetë me këste, ku secili do të jetë 10% e pagës mujore deri në shlyerjen e plotë të kësaj shume.

Nga dokumentacioni bankar i administruar gjatë hetimit, por dhe i depozituar nga subjekti së bashku me deklaratën “Vetting” provohet se znj. J., ka paguar në favor të Universitetit të A., shpenzimet e shkollimit të vajzës së subjektit sipas aktmarrëveshjeve të mësipërme.

35.2.1.2.2. Subjekti për të provuar aftësinë financiare të huadhënëses për dhënien e huas ka depozituar dokumentacion të plotë në përgjigje të pyetësonit nr.1 në lidhje me të ardhurat e familjes së znj. S. J.

⁴⁰ Huaja është deklaruar dhe në deklaratat periodike

35.2.1.2.3. Bazuar në dokumentacionin e depozituar nga subjekti, znj. J., ka patur të ardhurat e mëposhtme:

Viti 2010 – 130 415 CAD ose 13 600 980 lekë;
 Viti 2011 – 114 632 CAD ose 12 077 628 lekë;
 Viti 2012 – 101 188 CAD ose 10 763 368 lekë;
 Viti 2013 – 98 680 CAD ose 9 443 676 lekë;
 Viti 2014 – 91 038 CAD ose 9 062 833 lekë;
 Viti 2015 – 97 179 CAD ose 8 797 615 lekë;
 Vitit 2016 – 99 882 CAD ose 9 497 779 lekë.

35.2.1.2.4. Analizë financiare (në lekë) mbi mundësinë e zj. S.J., për të mbuluar shpenzimet e shkollimit të vajzës së subjektit.

Nga hetimi në lidhje me znj. S.J., ka rezultuar se:

- Në vitin 2002 ajo së bashku me familjen është larguar për në Kanada.
- Në Kanada, znj. J., ka në pronësi apartament të blerë me kredi.
- Në datë 13.7.2010 së bashku me bashkëshortin ka lidhur kontratë sipërmarrje për blerjen e një apartamenti në Tiranë tek kompleksi “Homeplan” për shumën 75.707 euro. Për këtë apartament është lidhur dhe kontrata e shitblerjes.
- Në datë 12.9.2016 z. Z. J., bashkëshorti i znj. S.J., ka blerë automjet “Daimler Chrysler” për shumën 6.000 euro. Ky automjet është shitur në datën 22.7.2019 për shumën 250,000 lekë.
- Aktualisht, z. J., ka në pronësi automjet tip “Benz” dhuruar nga i biri në datën 1.8.2019.
- Nga verifikimi i të dhënave në sistemin Tims, rezulton se çifti J., vijnë rregullisht çdo vit në Shqipëri, gjatë periudhës së verës.

Analizë financiare

	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	Total
Të Ardhura	13 600 980	12 077 628	10 763 368	9 443 676	9 062 833	8 797 615	9 497 779	73 243 879
Shpenzimet e jetesës	5 633 016	5 818 717	5 991 822	5 605 723	5 878 925	5 478 513	5 912 981	40 319 698
Prurje në Shqipëri/dhurata	208 580	316 080	691 405					1 216 065
Dhënë hua mbesës			1 221 970	1 296 952	2 827 722	2 496 577	1 212 791	9 056 013
Mundësia për Kursim kumulative	7 759 385	13 702 215	16 560 386	19 101 386	19 457 572	20 280 096	22 652 103	22 652 103

Kursi i këmbimit CAD:Lek i datës 31 Dhjetor të çdo viti, Banka e Shqipërisë

Në hartimin e analizës financiare janë mbajtur në konsideratë:

- Analiza financiare është bërë duke përdorur metodologjinë kumulative, pasi familja e Znj. S. J., nuk është subjekt deklarimi. Periudha e analizuar është 2010-2016.
- Të ardhurat neto përfshijnë:
 - o pagat e znj. S., dhe z. Z. J. Këto të ardhura janë marrë për secilin, nga “Deklarimi vjetor i të ardhurave individuale”, të kryer tek Agjencia Kanadeze e Deklarimit të të Ardhurave “CRA”.
 - o Shpenzimet e jetesës⁴¹, janë ato për një familje (*household*) sipas Anketës së buxhetit të familjes të publikuar nga Zyra e Statistikave të Kanadasë. Përbërja e familjes për efekt të shpenzimeve është konsideruar e njëjtë, pasi një prej djemve, mbaron studimet në vitin 2011 dhe largohet në tjetër qytet, ndërkohë që S. H., shkon në Canada në vitin 2012. Në shpenzimet e jetesës janë përfshirë dhe ato të znj. S. H.

⁴¹ <https://www.150.statcan.gc.ca/t1/tb11/en/tv.action?pid=1110022301>

- Prurjet /dhuratat në Shqipëri përkatësisht, në shumën 2,000 CAD ose 208,580 lekë në vitin 2010, shumën 3,000 Cad ose 316,080 lekë në vitin 2011 dhe shumën 6,500 CAD (3,000 sjellë në Shqipëri dhe 3,500 dhuruar mbesës S. H.) ose 691,405 lekë. Gjithsej shuma 1,216,065 lekë.

35.2.1.2.5. Nga analiza financiare rezulton se motra e bashkëshortit ka patur të ardhura të mjaftueshme për të dhuruar shumën 11,500 CAD ose 1 216 065 lekë për periudhën 2010-2011, për të dhënë huat dhe për të mbuluar shpenzimet e jetesës së vajzës së subjektit gjatë studimeve të saj.

35.2.3. Në DVP-në/2017, vajza e subjekti deklaroi hua për blerjen e makinës “Volkswagen Tiguan” shumën 22,273.27 CAD ose 1 974 303 lekë nga data 26.4.2017-12 .4.2023.

Vajza e subjektit në datë 12.04.2017 ka blerë automjet “Volkswagen Tiguan” për shumën 22,273.27 CAD ose 1 974 303 lekë . Burimi për blerjen e këtij automjeti është kredia e marrë në “Scotia Bank” në shumën 22,273.27 CAD ose 1 974 303 lekë . Pagesa totale 27,416.81 CAD ose 2 430 226 lekë.

Nga analiza financiare, duke qenë se burim është kredia e marrë në “Scotia Bank”, rezulton se vajza e subjektit ka patur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e këtij automjeti.

35.3. Nga dokumentacioni i administruar gjatë hetimit administrativ rezulton se djali i subjektit të rivlerësimit ka patur **të ardhurat** e mëposhtme vjetore:

- Viti 2016, shuma 4,250 CAD⁴² ose 404 133 lekë;
- Viti 2017, shuma 9,652 CAD ose 855 553 lekë;
- Viti 2018, shuma 17 000 CAD ose 1 347 057 lekë;
- Viti 2019, shuma 18 067 CAD ose 1 506 426 lekë.

35.4. Analizë financiare në lidhje me shpenzimet e shkollimit të djalit dhe vajzës së subjektit dhe jetesës së dy fëmijëve të subjektit në Kanada – në lekë

—	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	Totali
PASURI	702 789	-551 706	136 812	-39 749	3 485 460	4 328 837	913 679	8 976 121
Asete të tjera	0	0	0	0	318 354	2 510 169	556 633	3 385 155
<i>Ndryshim likuiditetesh</i>	<i>702 789</i>	<i>-551 706</i>	<i>136 812</i>	<i>-39 749</i>	<i>3 167 106</i>	<i>1 818 668</i>	<i>357 046</i>	<i>5 590 966</i>
TË ARDHURA	2 072 930	2 199 300	4 048 744	3 711 259	7 717 146	10 807 943	9 106 238	39 663 561
Të ardhura nga paga e S. H.		328 148	972 148	1 005 155	5 059 549	6 401 049	6 099 385	19 865 433
Të ardhura nga paga e O. H.						855 553	1 347 057	2 202 610
Të ardhura të tjera	2 072 930	1 871 152	3 076 597	2 706 105	2 657 597	3 551 341	1 659 796	17 595 518
SHPENZIME	1 234 203	2 501 184	3 136 363	2 786 273	4 992 820	6 819 348	7 834 089	29 304 280
Shpenzime jetese					1 031 857	2 957 060	2 957 060	6 945 976
Shpenzime shkollimi S. H.	1 234 203	2 443 764	3 076 633	2 677 637	1 307 881			10 740 117
Shpenzime shkollimi O.H.					1 286 118	2 570 726	2 718 316	6 575 160
Shpenzime të tjera	0	57 420	59 730	108 636	1 366 964	1 291 563	2 158 713	5 043 027
Mundësia për kursime (Kumulative)	135 939	385 761	1 161 331	2 126 066	1 364 931	1 024 689	1 383 160	1 383 160

Kursi i këmbimit CAD:Lek data 31 Dhjetor i çdo viti, Banka e Shqipërisë

⁴² Bursë nga Universiteti i A.

Në hartimin e analizës financiare janë mbajtur në konsideratë:

- Periudha e analizuar fillon nga shtatori i vitit 2012-2018;
- Analiza financiare është bërë duke përdorur metodologjinë kumulative;
- Të ardhurat nga pagat për S. H., për vitet 2013 deri 2018 dhe të O. H., për vitet 2017-2018. Këto të ardhura janë marrë për secilin, nga “Deklarimi vjetor i të ardhurave individuale”, i kryer tek Agjencia Kanadeze e Deklarimit të të Ardhurave “CRA”.
- Të ardhura të tjera përfshijnë:
 - o Bursat e akorduara nga Universiteti i A., për S. H., janë 4,500 CAD ose 478 665 lekë për vitin 2012, 6,000 CAD ose 574 200 lekë për vitin 2013, 2,500 CAD ose 248 875 lekë për vitin 2014, 2,000 CAD ose 181 060 lekë për vitin 2015 dhe 1,000 CAD ose 95 090 lekë për vitin 2016. Gjithsej shuma 1 577 890 lekë. Për O. H., janë 4,250 CAD ose 404 133 lekë për vitin 2016, 5,500 CAD ose 487 520 lekë për vitin 2017 dhe 2,250 CAD ose 178 245 lekë për vitin 2018. Gjithsej shuma 1 069 898 lekë. Bursat janë nxjerrë nga faturat e pagesës së universitetit, për çdo semestër, çdo vit.
 - o Dhuratë nga znj. S. J., tek znj. S. H., në shumën 3,500 CAD ose 372,295 lekë, në vitin 2012. Kjo është bazuar në deklarin e bërë në DPV-në/2012.
 - o Pagesë për tarifën e shkollës, në shumën 756 800 lekë, kryer nga prindërit në vitin 2016 për O. H.
 - o Huan e dhënë nga znj. S. J., për znj. S. H.
- Shpenzimet e jetesës deri në shtator 2016 për znj. S. H., janë mbuluar nga halla e saj S. J. Ato janë përfshirë në analizën financiare të familjes së hallës. Nga shtatori 2016 e deri e deri në fund të 2018-ës, janë përlogaritur shpenzime jetese për dy persona, pasi S., dhe O. H., banojnë në shtëpinë e hallës, por i përballojnë vetë shpenzimet. Shpenzimet e jetesës janë bazuar tek të dhënat e Anketës Buxhetit të Familjes të publikuar nga Zyra e Statistikave të Kanadasë⁴³. Ato janë reduktuar me shpenzimet për akomodim dhe shkollim, sipas strukturës së shpenzimeve të buxhetit të familjes për vitin 2017.
- Shpenzimet e shkollimit për secilin nga fëmijët janë marrë nga faturat elektronike të Universitetit të A., nxjerrjet e logarive bankare të z. O. H., znj. S. H., dhe znj. S. J., si dhe mandatpagesat bankare vënë në dispozicion nga subjekti.
- Shpenzime të tjera përfshijnë:
 - o Shpenzimet e udhëtimit sipas sistemit TIMS si dhe shpenzimet e deklaruara për fëmijët në pyetësorin standard.
 - o Shumat mbi shlyerjen e kredisë së makinës janë marrë në bazë të planit të pagesave për kredinë bankare nga “Scotia Bank”, ku tregohet kësti dhe data e pagesës së tij.
 - o Shumat mbi shlyerjet e huas tek halla, janë marrë në bazë të DPV-ve ndër vite nga vajza S. H., si dhe nga pyetësori nr.1. Këto shuma janë ballafaquar me marrëveshjet të cilat përcaktonin shlyerje jo më pak se 10% e shumës së kredisë.
- Asetet e tjera përfshijnë:
 - o Shumën e plotë të aksioneve të blera nga S. H., ½ e të cilave paguhet nga S., dhe ½ nga punëdhënësi. Vlera e aksioneve në ditën e blerjes dhe shumat e paguara nga secili, janë marrë nga *statement* i planit të aksioneve. Shuma e paguar nga S. H., është verifikuar edhe me lëvizjen e llogarisë së pagës në bankën “TD Canada Trust”.
 - o Shumën e plotë të investuar në *Planin e Pensionit* nga Siva Hoxha, ½ e të cilave paguhet nga S., dhe ½ nga punëdhënësi. Shumat e paguara nga secili, janë marrë nga *statement* i *Planit të Pensioneve*. Shuma e paguar nga S. H., është verifikuar me lëvizjen e llogarisë së pagës në bankën “TD Canada Trust”.
 - o Automjetin “Volkswagen”, e blerë nëpërmjet kredisë bankare.
- Ndryshimin e likuiditeteve – shtesën ose pakësimin – për të dy fëmijët, sipas gjendjes në 31 dhjetor të çdo viti, nxjerrë nga lëvizjet bankare të të gjitha llogarive të secilit.

43 <https://www.150.statcan.gc.ca/t1/tbl1/en/tv.action?pid=1110022301>

Nga analiza financiare rezulton se djali dhe vajza e subjektit kanë të ardhura të mjaftueshme për të paguar shkollimin si dhe për të përballuar shpenzimet e jetesës.

🚩 Konkluzioni i Komisionit mbi vlerësimin e pasurisë

36. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht, si dhe ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht në deklaratën “Vetting”, pasuritë e tij dhe personave të lidhur me të, ashtu siç parashikohet në pikën 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

36.1. Subjekti ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë. Ajo ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së saj. Nga hetimi ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk është përpjekur të fshehtë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij. Kjo do të thotë që në rastin e subjektit të rivlerësimit, znj. Valdete Hoxha, nuk vërtetohen shkaqet që Kushtetuta i ka parashikuar të tilla, që, nëse vërtetohen, do të zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit.

36.2. Për sa më sipër, trupi gjyqës vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Valdete Hoxha, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të germës “a”, të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

37. Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (referuar si “DSIK”), ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, znj. Valdete Hoxha, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka/ka patur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

37.1. Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit 84/2016, ka dërguar në Komisionin e Pavaruar të Kualifikimit raportin⁴⁴ mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, znj. Valdete Hoxha, ku ka konstatuar se, (i) formulari i deklarimit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) subjekti ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara në deklaratën për kontrollin e figurës si dhe; (iii) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

37.2. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës.

37.3. Komisioni kreu një hetim të pavarur për kontrollin e figurës dhe integritetit të subjektit të rivlerësimit, znj. Valdete Hoxha, përfshirë këtu edhe verifikimin e informacioneve të dërguara rishtazi nga agjensitë ligjzbatuese. Nga hetimi administrativ, i kryer nga Komisioni, nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirjen e tij në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

⁴⁴ Raporti me nr. *** prot., datë 2.11.2017 (deklasifikuar plotësisht me vendimin e K.D.Zh., nr. ***, dat 11.9.2019)

✚ Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës

38. Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Valdete Hoxha, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI PROFESIONAL

✚ Raporti i hartuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor

39. Ky raport është përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

39.1. Hartimi i këtij raporti është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (1) formularit të vetëdeklarimit, të 3 dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit; (2) pesë dosjeve gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; dhe (3) të dhënat nga burimet arkivore të KLD-së.

39.2. Raporti ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit: (a) aftësitë profesionale; (b) aftësitë organizative; (c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; dhe (ç) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

39.3. Saktësia e formularit të vetëdeklarimit: formulari paraqitet i plotë dhe i nënshkruar në çdo faqe, sipas parashikimit të udhëzimit të shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

39.4. Të dhëna nga burime arkivore të KLD-së: **(i)** Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 - 8 tetor 2016”, për gjyqtaren Valdete Hoxha është paraqitur 1 ankesë në vitin 2014 në Inspektoratin e KLD-së. Ankesa është arkivuar pas shqyrtimit fillestar të saj, me arsyetimin se është tej afatit 5- vjeçar. **(ii)** Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për gjyqtaren Valdete Hoxha përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

39.5. Nga ana e Komisionit⁴⁵ i është kërkuar informacion Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Ministrisë së Drejtësisë në lidhje me subjektin e rivlerësimit. **(i)** Bazuar në shkresën e Ministrisë së Drejtësisë nr. *** prot., datë 5.4.2019 për subjektin e rivlerësimit rezultojnë dy ankesa të cilat janë shqyrtuar nga ana e Ministrisë, duke u konstatuar prej saj se ato i përkasin vendimarrjes së gjykatës dhe, për rrjedhojë, shqyrtimi i tyre nuk është në kompetencë të Ministrisë. **(ii)** Bazuar me shkresën nr. *** prot., datë 11.3.2019, KLGJ-ja ka vënë në dispozicion informacionin e kërkuar nga ku rezulton se për subjektin janë paraqitur 6 ankesa, të cilat pasi janë analizuar nga ana e KPK-së është konstatuar se nuk paraqiten shkaqe apo rrethana për të treguar veprime të njënashme apo korruptive nga ana e subjekti të rivlerësimit.

40. Analiza e gjetjeve: analiza e gjetjeve i referohet të dhënave të nxjerra nga tre grupet e burimeve të informacionit: (1) formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur

⁴⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 22.2.2019, drejtuar KLGJ-së dhe Ministrisë së Drejtësisë.

nga vetë subjekti; (2) pesë dosjeve të vëzhguara të përzgjedhura me short; dhe (3) të dhënat nga burimet arkivore në KLD.

i. Aftësitë profesionale

40.1. Njohuritë ligjore: subjekti i rivlerësimit ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit.

Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se ajo identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret.

Ka njohuri për rëndësinë e natyrës së mosmarrëveshjes lidhur me zgjidhjen e çështjes.

Ka njohuri në fushat civile të përgjithshme, identifikon ligjin e posaçëm që duhet zbatuar dhe interpreton drejt atë, duke saktësuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë, ka njohuri në fushën administrative, ku gjyqtarja ka dhënë vendime si gjyqtare e deleguar në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, duke e gjykuar çështjen dhe vendosur ndryshimin e vendimit të shkallës së parë.

Për 5 dosjet gjyqsore të zgjedhura me short, rezultojnë se është paraqitur rekurs vetëm në një rast, rasti i dosjes penale nr. 5. Në këtë rast, Gjykata e Lartë ka vendosur “Mospranimin e rekursit”. Për katër dosjet e tjera nuk është paraqitur rekurs, pra, rezultojnë se palët kanë pranuar në këtë mënyrë ligjshmërinë e vendimeve të dhëna nga gjykata e apelit.

40.2. Arsyetimi ligjor: subjekti i rivlerësimit ka aftësi në arsyetim ligjor

Vendimet gjyqsore përfundimtare të arsyetuara prej saj, janë të qarta dhe të kuptueshme.

Struktura e vendimeve të saj është e qëndrueshme, e mirëorganizuar dhe e standardizuar. Ajo përmban elementët e kërkuar nga legjislacioni procedural, civil e penal.

Subjekti i rivlerësimit mban të njëjtin stil në hartimin e akteve dhe organizimi strukturor i vendimeve paraqitet në nivel të kënaqshëm.

Përmbajtja e vendimit përfundimtar është gjithëpërfshirëse dhe i jepet përgjigje pretendimeve të palëve. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtari. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore, e cila paraqitet e thjeshtë dhe e kuptueshme.

Gjyqtarja paraqet raste kur i referohet vendimeve unifikuuese të Gjykatës së Lartë.

Gjyqtarja u referohet dhe ligjeve të posaçme kur konstaton se lidhet me objektin e gjykimit.

Niveli i arsyetimit të vendimeve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor.

ii. Aftësitë organizative

40.3. Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë: subjekti i rivlerësimit në periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016 ka kryer detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Apelit Tiranë, në seksionin civil dhe penal.

Sipas të dhënave statistikore, të përcjella nga Gjykata e Apelit për efekt të organizimit të shortit në këtë gjykatë, konstatohet se për periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016, subjekti ka përfunduar 858 çështje, nga të cilat 550 penale dhe 308 çështje civile, (nga këto 301 civile të përgjithshme, 7 civile familjare). Gjatë vitit 2014, gjyqtarja Valdete Hoxha, ka gjykuar dhe 47 çështje, e deleguar pranë Gjykatës së Apelit Administrativ Tiranë. Përfundimisht çështje të gjykuara, për periudhën e rivlerësimit janë **905 çështje**.

Në sistemin e vlerësimit, Aneksi 1, pika 3, “Standardi sasior”, pikës 3, shkronja “i”, përcaktohet se gjyqtari i gjykatës së apelit i dhomës civile, duhet të jetë në cilësinë e relatorit në jo më pak se 200 gjykime çështjesh civile brenda një viti kalendarik, ndërsa në shkronjën “h”, se gjyqtari i gjykatës së apelit i dhomës penale, si relator jo më pak se 150 çështje penale. Duke qënë se subjekti i rivlerësimit ka punuar si pranë dhomës civile dhe pranë dhomës penale, përafërsisht në raportin 50% me 50% të çështjeve, në këtë rast, kur çështjet janë të përziera, duke zbatuar këtë rregull nënkuptohet një ngarkesë sasimore prej jo më pak se 525

gjykime çështjesh civile dhe penale, për periudhën prej tre vjetësh. Për subjektin konstatohet se ngarkesa e saj sasiore ka qenë mbi standardin sasior.

Si datë e arsyetimit të vendimit, është vlerësuar data e dorëzimit të dosjes gjyqësore në sekretari, si e dhëna e vetme objektive për këtë fakt. Lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, nga vëzhgimi i 5 dosjeve të shortuara, rezultoi se subjekti i kushton rëndësi të veçantë arsyetimit në kohë të shpejtë të vendimeve.

Të gjitha vendimet janë arsyetuar brenda afatit, pasi nuk konstatohet në asnjë rast, të jetë tejkalluar afati i rekursit prej 30 ditësh.

Së fundmi, duke konsideruar të dhënat e mësipërme, duhet evidentuar se subjekti ka patur ngarkesë sasiore mbi standardin minimal. Ajo ka respektuar afatet standarde të gjykimit të çështjeve që i janë caktuar, si dhe ka arsyetuar pa vonesë vendimet gjyqësore.

40.4. Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore: subjekti i rivlerësimit ka aftësi për të kryer procedurat gjyqësore në funksion të zgjidhjes së çështjeve.

Subjekti është i qartë për rolin e gjykatës së apelit dhe kryen veprimet e nevojshme procedurale për zgjidhjen e pretendimeve të paraqitura në ankimimin e palëve, duke qenë i qartë në veprimet procedurale që realizon.

Ndër 5 dosjet e vëzhguara, në një rast është vendosur ndryshimi i vendimit të gjykatës së faktit, ndërsa në katër rastet e tjera është vendosur “lënia në fuqi e vendimit”.

Rezulton se prej 5 vendimeve, të 5 dosjeve të vëzhguara, është paraqitur rekurs vetëm për dosjen 5 dhe Gjykata e Lartë, pas shqyrtimit ka vendosur “mospranimin e rekursit”.

Vendimet e dhëna nga subjekti në cilësinë e relatorit, në të katër rastet e tjera, janë pranuar nga palët pa paraqitur rekurs, gjë që dëshmon për aftësinë e gjykatës për të bindur palët në drejtësinë e vendimit të dhënë.

40.5. Aftësia për të administruar dosjet: nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, përgjithësisht, nuk janë konstatuar mangësi në aftësitë për të administruar dosjet dhe për të mbikëqyrur saktësinë dhe plotësinë e akteve që përfshihen në të.

Është konstatuar se aktet e hartuara nga gjykata janë të rregullta, të sakta dhe të plota. Procesverbalit gjyqësor dokumenton gjykatën, trupin gjykues, palët, objektin, kohën dhe vendin, si dhe veprimet që kryhen në seancë, konform kërkesave të Kodit të Procedurës Civile dhe Kodit të Procedurës Penale.

Vendimet e ndërmjetme fiksohen në procesverbalin e seancës gjyqësore.

Dosjet janë të inventarizuara rregullisht.

iii. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

40.6. Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave dhe i procedimeve disiplinore, nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të subjektit. Edhe nga vëzhgimi i 5 dosjeve nuk rezultuan të dhëna negative për këtë aspekt.

40.7. Integriteti: Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

40.8. Paanësia: Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit.

Për vetë gjyqtaren, në asnjë prej 5 dosjeve të vëzhguara nuk ka patur kërkesa për përjashtimin e saj nga gjykimi i çështjeve.

Nga ana tjetër, asnjë prej 3 dokumenteve ligjore dhe 5 dosjeve të vëzhguara nuk lidhen me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave.

Në 3 dokumentet ligjore dhe në aktet e 5 dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të

rivlerësimit. Po ashtu nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit nuk ka respektuar rregullat procedurale.

iv. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

40.9. Aftësitë e komunikimit: Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor në format letër, është konstatuar se komunikimi ka qenë i qartë dhe i rregullt. Gjuha e përdorur në seancë gjyqësore dhe në akte tek 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë.

40.10. Aftësia për të bashkëpunuar: Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta.

Në këtë aspekt duhet evidentuar se nuk ka patur asnjë seancë gjyqësore të dështuar nga planifikimi dhe se përgjithësisht nuk ka patur vonesa në arsyetimin e vendimeve gjyqësore, që tregojnë jo vetëm produktivitetin e punës së saj, por edhe bashkëveprimin normal me anëtarët e trupit gjykues dhe administratën gjyqësore.

40.11. Gatishmëria për t'u angazhuar: Subjekti i rivlerësimit i ka kushtuar rëndësi formimit akademik. Për shkak të funksionit të gjyqtarit të shkallës së dytë që kryen, ajo i nënshtrohet detyrimit programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Në periudhën e rivlerësimit, ajo ka marrë pjesë dhe është certifikuar në 11 seminare të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës.

Këto të dhëna tregojnë se ajo ka marrë pjesë në 16 ditë, të formimit vazhdues për një periudhë trevjeçare. Lënda e trajnimeve, ku ajo ka marrë pjesë, ka një lidhje të arsyeshme me detyrën e gjyqtarit të shkallës së dytë, në përbërje të dhomës civile dhe penale.

Ajo ka marrë pjesë dhe në aktivitete të tjera, jashtë Shkollës së Magjistraturës, por këto i janë zhvilluar para periudhës së rivlerësimit kalimtar.

✚ Rivlerësimi i aftësive profesionale i kryer nga Komisioni

41. Hetimi i Komisionit lidhur me këtë kriter është bazuar në verifikimin dhe analizimin e: (i) Raportit për analizimin e aftësisë profesionale të kryer nga KLGJ-ja dhe dokumentacionin bashkëlidhur tij; (ii) vlerësimit të denoncimeve të paraqitura dhe shqyrtimit të dokumentacionit të dërguar në ankesat e subjekteve denoncuese; (iii) kriterëve të vlerësimit të parashikuara në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (neni 71 e vijues i tij).

41.1. Komisioni, me qëllim të vlerësimit të veprimtarisë etike dhe profesionale verifikoi dhe analizoi në mënyrë të pavaruar 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, 5 dosjet penale të përzgjedhura me short si edhe të dhënat nga burimet arkivore të KLD-së.

41.2. Pas verifikimit të raportit për analizën e aftësive profesionale të kryer nga KLGJ-ja, 3 dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, 5 dosjeve penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor si dhe të dhënave nga burimet arkivore mbi të cilën është hartuar ky raport, Komisioni nuk konstatoi problematika lidhur me vlerësimin profesional.

❖ Denoncimet e publikut të depozituara në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit

42. Për subjektin e rivlerësimit Valdete Hoxha janë administruar tridhjetë e katër denoncime të paraqitura pranë KPK-së.

42.1. Pas analizimit të dokumentacionit të administruar, për shkak të këtyre denoncimeve, rezultoi se nuk paraqiten shkaqe apo rrethana për të treguar veprime të njëanshme apo korruptive nga ana e subjektit të rivlerësimit.

Konkluzione për kriterin e vlerësimit profesional

43. Pas shqyrtimit të raportit të hartuar nga KLGJ-ja, denoncimeve të depozituara në Komision dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si më sipër, trupi gjykues vëren se nuk mund të ngrihen dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e gjyqtarit.

43.1. Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme dhe, konsiderohet “i aftë” në aspektin profesional.

43.2. Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se, subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

V. KONKLUSIONE PËRFUNDIMTARE

Trupi Gjykuesi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, u njoh me rrethanat e çështjes dhe rezultatet e hetimit për komponentin e pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale si dhe nuk evidentoi asnjë arsye në komponentin e figurës që do të shërbente për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit. Subjekti ka bashkëpunuar plotësisht me Komisionin në lidhje me të gjitha aspektet e hetimit, ajo ka dhënë informacion të plotë në lidhje me të ardhurat, pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme si dhe pozicionin e saj financiar dhe të anëtarëve të familjes. Në karrierën e saj gjyqësore ajo ka treguar njohuri të mjaftueshme ligjore në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit, arsyetim ligjor, ka aftësi organizative, si dhe etikë e profesionalizëm në punë për të vazhduar ushtrimin e detyrës.

Në përfundim, trupi gjykues, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, pasi dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konkludon se:

- i. subjekti arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- ii. subjekti arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës dhe;
- iii. subjekti ka një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, referuar në nenin 4, pika 2, nenin 58, pika 1, germa “a”, si dhe në nenin 59, pika 1 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Valdete Hoxha.

2. Vendimi i arsyetuar, me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më 1.7.2020

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Lulzim HAMITAJ
Kryesues

Valbona SANXHAKTARI
Anëtare

Genta TAFA (BUNGO)
Relatore

Sekretare gjyqësore
Fiorela MANDRO